

MANUALI PËR TË DREJTAT E PAKICAVE
BAZUAR NË PRAKTIKËN E GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT



Ministarstvo ljudskih
i manjinskih prava



CENTRE FOR MONITORING AND RESEARCH

MANUALI PËR TË DREJTAT E PAKICAVE
BAZUAR NË PRAKTIKËN E GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT



MANUALI PËR TË DREJTAT E PAKICAVE BAZUAR NË PRAKTIKËN E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT



Qendra për Monitorim dhe Kërkime - CeMI
Bul. Svetog Petra Cetinjskog 96, VI/12
E-mail: info@cemi.org.me
www.cemi.org.me

Redaktor:
Zlatko Vujović

Autori:
Nenad Koprivica

Shtypi:
Smart Print

Qarkullimi:
100



**Ministarstvo ljudskih
i manjinskih prava**

Publikimi është krijuar në kuadër të projektit „Kontributi në mbrojtjen e të drejtave të popujve pakicë në procedurat gjyqësore”, që Qendra për Monitorim dhe Kërkime (CeMI) realizon në partneritet me Institutin për Studime Juridike (IPLS), dhe financohet nga Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim përfaqësojnë qëndrimet e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të donatorëve.

**MANUALI PËR TË DREJTAT E PAKICAVE
BAZUAR NË PRAKTIKËN E GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

PËRMBAJTJA

RRETH PROJEKTIT	7
I HYRJE	8
II TË DREJTAT E PAKICAVE SIPAS KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (ECHR)	10
III DISA NGA AKTGJYKIMET KRYESORE TË GJEDNJ PËR TË DREJTAT E PAKICAVE	20
IV TRENDET NË PRAKTIKËN GJYQËSORE	26
V REKOMANDIME PËR KOMUNITETET PAKICË	28
VI NË VEND TË PËRFUNDIMIT	30
VII BURIMET	32

RRETH PROJEKTIT

Qendra për Monitorim dhe Kërkime (CeMI) në partneritet me Institutin për Studime Juridike (IPLS) realizon projektin “Kontributi në mbrojtjen e të drejtave të popujve pakicë në procedurat gjyqësore” me mbështetje financiare nga Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave.

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare pakicë, si analizimi i trajtimit nga institucionet gjyqësore ndaj popujve pakicë dhe komuniteteve kombëtare pakicë.

Projekti përbëhet nga një sërë aktivitete të fokusuar në mbështetjen e popujve pakicë në Mal të Zi, duke përmirësuar të drejtat e tyre në procedurat gjyqësore. Aktivitetet kryesore përfshijnë monitorimin e procedurave gjyqësore, analizën e çështjeve të përfunduara me vendime ligjore dhe vlerësimin e përputhshmërisë me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), veçanërisht në çështjet penale që lidhen me të drejtat e pakicave.

Përveç kësaj, projekti përfshiu fushata edukative, duke krijuar video dhe infografika mbi të drejtat e popujve pakicë, me fokus me standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar. Videot u titruan në gjuhën shqipe dhe rome, duke rritur kështu qasjen e informacionit.

Një nga produktet më të rëndësishme të projektit është manuali për të drejtat e pakicave, i bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, i cili ofron këshilla praktike dhe udhëzime për realizimin efektiv të të drejtave. Gjithashtu, është përgatitur edhe raport mbi monitorimin e aktgjykimeve, i cili analizon gjetjet kryesore dhe ofron rekomandime për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

Ky projekt siguroi psqyurim më të mirë mbi sfidat me të cilat përballen pakicat në sistemin gjyqësor dhe, përmes edukimit dhe analizave, synoi të sigurojë mbrojtjen dhe promovimin afatgjatë të të drejtave të tyre në Mal të Zi.

HYRJE

Qëllimi i këtij Manuali është të ndihmojë në kuptimin e aktgjykimet përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe të ofrojë udhëzime për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave në Mal të Zi. Manuali ofron një pasqyrë të parimeve kryesore që rrjedhin nga praktika e GJEDNJ-së dhe është i synuar për komunitetet pakicë në Mal të Zi, për t'i ndihmuar të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre në bazë të praktikës së GJEDNJ-së. GJEDNJ-ja luan rolin kyç në mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbarë Evropën, përfshirë edhe të drejtat e komuniteteve pakicë. Mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare është një nga kriteret kryesore për hyrjen e Malit të Zi në Bashkimin Evropian. Mali i Zi ka marrë një sërë obligimesh ndërkombëtare në këtë fushë, duke përfshirë Konventën kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Megjithatë, duke pasur parasysh se sfidat e rëndësishme ende ekzistojnë, Manuali analizon disa nga aktgjykimet më të rëndësishme të GJEDNJ-së që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me gjendjen e të drejtave të pakicave në Mal të Zi, me synimin për të ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të standardeve dhe detyrimeve që dalin nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PREZANTIM I SHKURTËR I GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (GJEDNJ)

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është gjykatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1959, me seli në Strasburg. Detyra e Gjykatës është të mbikëqyrë zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokolleve të saj nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Gjykata ka juridiksion për të vendosur mbi ankesat e paraqitura nga individët ose shtetet kundër vendeve që kanë nënshkruar Konventën, nëse janë subjekt të shkeljes të të drejtave të njeriut. Vendimet e GJEDNJ-së janë juridikisht të

1 https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Questions_Answers_MNE

detyrueshme për shtetet, dhe puna e Gjyqit është thelbësor për respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit në kontekstin evropian. Gjykata përbëhet nga një numër gjyqtarësh të barabartë me numrin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që kanë ratifikuar Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore – aktualisht 46. Gjyqtarët e Gjykatës gjykojnë si individë dhe nuk përfaqësojnë asnjë shtet. Në përpunimin e kërkesës, Gjykatës i ndihmon Sekretariati i përbërë kryesisht nga juristë nga të gjitha shtetet (të njohur gjithashtu si këshilltarë juridikë). Këta janë plotësisht të pavarur nga vendet e tyre të origjinës dhe nuk përfaqësojnë as individët që bëjnë kërkesën dhe as shtetet.

ROLI I GJEDNJ-SË NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË EVROPË

Roli i GJEDNJ-së në mbrojtjen e të drejtave të njeriut është kyç për respektimin e drejtësisë dhe barazisë në Evropë. Me aktgjykimet e tij, Gjykata siguron që shtetet të respektojnë të drejtat themelore të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe protokollet shtesë. GJEDNJ-a merret me një gamë të gjerë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e shprehjes, të drejtën për aktgjykim të drejtë, mbrojtjen nga tortura, si dhe të drejtat e pakicave. Gjykimet e Gjykatës shpesh formojnë praktikën ligjore dhe vendosin standarte që kanë një ndikim afatgjatë në sistemet ligjore kombëtare dhe politikat e shteteve anëtare.

TË DREJTAT E PAKICAVE SIPAS KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (ECHR)

RËNDËSIA E TË DREJTAVE TË PAKICAVE NË KONTEKSTIN E SISTEMIT EVROPIAN TË MBROJTJES TË DREJTAVE TË NJERIUT

Të drejtat e pakicave përbëjnë komponentin kyç të sistemit evropian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe rëndësia e tyre bëhet veçanërisht e dukshme përmes praktikës së GJEDNJ-së. Gjykata vazhdimisht zhvillon standarde që mbrojnë diversitetin kulturor, gjuhësor dhe fetar të komuniteteve pakicë, si dhe barazinë e tyre në shoqëri. Në kontekstin e shoqërive evropiane bashkëkohore, të cilat përballen me sfida të multikulturalizmit, GJEDNJ luan një rol kyç në garancinë që pakicat nuk diskriminohen dhe se ata gëzojnë të njëjtat të drejta dhe liri si popullsia shumicë.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR)² dhe instrumentet ndërkombëtarë të tjerë relevantë, si Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare³ Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave⁴, sigurojnë bazën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Ky kuadër ligjor e njih faktin se, ndonëse të drejtat e njeriut janë universale, të drejtat specifike për pakicat mund të jenë të nevojshme për të siguruar barazinë, respektin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në shoqëri.

2 https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Convention_MNE

3 <https://rm.coe.int/okvirna-konvencija-za-zastitu-nacionalnih-manjina/168094dfe6>

4 https://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Source/CharterText/ExplRpt_ba.pdf

1. ÇFARË NËNKUPTOHET ME TË DREJTAT E PAKICAVE SIPAS KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (ECHR)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) nuk përmban një dispozitë eksplicite që i referohet ekskluzivisht të drejtave të pakicave, por përmes dispozitave të saj të përgjithshme mbi të drejtat dhe liritë e njeriut mund të interpretohet edhe e drejta e pakicave për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi. Për mbrojtjen konkrete të të drejtave të pakicave, e rëndësishme është edhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përmes aktgjykimeve të ndryshme ka konfirmuar të drejtën e pakicave për ruajtjen e identitetit të tyre dhe ndalimin e diskriminimit. GJEDNJ, përmes aktgjykimeve të saj, mbron të drejtat e komuniteteve pakicë në fusha të tilla si:

- **Neni 14 – Ndalimi i diskriminimit:** Ky nen i Konventës siguron mbrojtje nga diskriminimi mbi bazë të ndryshme, duke përfshirë përkatësinë etnike, gjuhën, fenë, mendimet politike, origjinën kombëtare ose shoqërore, si dhe cilësi të tjera. Për komunitetet pakicë, neni 14 përfaqëson një mbrojtje kyçe pasi garanton që të gjithë anëtarët e shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia e tyre pakicë, të kenë mundësi të barabarta për realizimin e të drejtave të njeriut. Diskriminimi ndaj grupeve pakicë mund të shfaqet në mënyra të ndryshme, nga marginalizimi institucional, vështirësitë në aksesin ndaj shërbimeve arsimore dhe shëndetësore, deri te dhuna dhe gjuha e urrejtjes. Neni 14 ndalon një diskriminim të tillë, duke garantuar që pjesëtarët e komuniteteve pakicë të kenë të drejta të barabarta.

GJEDNJ në praktikën e saj ka trajtuar në detaje raste të diskriminimit ndaj grupeve pakicë, përfshirë pakicat etnike, fetare dhe gjuhësore. Gjykata ka përcaktuar qartë se diskriminimi në këtë kontekst nuk është vetëm i drejtpërdrejtë, por edhe ai indirekt, ku masat e caktuara mund të kenë një ndikim negativ disproporcional ndaj komuniteteve pakicë. Gjykata thekson gjithashtu se, përveç rasteve të dukshme të diskriminimit, duhet të shqyrtohet edhe ekzistenca e çdo pengese ose pengimi që lidhet me grupet pakicë.

Shembuj nga praktika e GJEDNJ:

Timishev kundër Ruisë (2005)⁵ – Në këtë rast, Gjykata vendosi mbi një rast diskriminimi ndaj pjesëtarëve të pakicës çeçene, duke deklaruar se kufizimi i lirisë së lëvizjes në bazë të përkatësisë etnike përbënte shkelje të nenit 14 të Konventë, sepse veprimet e shtetit (Ruisë) ndaj Çeçenëve ishin të pabarabarta dhe diskriminuese. Gjykata konstatoi se diskriminimi në bazë etnike mund të çojë në pasoja të rënda për të drejtat dhe liritë e njeriut të komuniteteve pakicë.

Güveç kundër Turqisë (2009)⁶ – Në këtë rast, Gjykata vendosi për diskriminim në lidhje me të drejtën për arsimim, ku anëtarët e komuniteteve pakicë etnike dhe fetare në Turqi ishin të ekspozuar ndaj trajtimit të pabarabartë në sistemin arsimor. Gjykata konstatoi se një sjellje e tillë ishte shkelje e nenit 14, për shkak se pakicat ishin diskriminuar në ushtrimin e të drejtave të tyre arsimore dhe kjo kishte pasoja negative afatgjata për pozitën e tyre në shoqëri.

Sejdiq dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës (2009)⁷ – Ky aktgjykim lidhet me rastin ku pjesëtarët e pakicave etnike (Romë dhe Hebrenj) ishin të përjashtuar nga jeta politike për shkak të dispozitave specifike kushtetuese që favorizonin grupe të caktuara etnike. Gjykata vendosi se diskriminimi ndaj grupeve pakicë përbënte shkelje të nenit 14 të Konventës, pasi disa qytetarë ishin të përjashtuar nga procesi politik bazuar në përkatësinë e tyre etnike, gjë që përfaqësonte një formë serioze të diskriminimit.

Diskriminimi indirekt dhe proporcionaliteti:

Neni 14 nuk mbron vetëm nga diskriminimi i dukshëm, por përfshin gjithashtu edhe diskriminimin indirekt. Kjo nënkupton

5 https://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Source/CharterText/ExplRpt_ba.pdf

6 https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_6_criminal_srp

7 [https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:\[%22Sejdic%20Finci%20v%20Bosnia%22\],%22documentcollectionid%22:\[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22\],%22itemid%22:\[%22001-96491%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:[%22Sejdic%20Finci%20v%20Bosnia%22],%22documentcollectionid%22:[%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22],%22itemid%22:[%22001-96491%22]})

se shteti mund të zbatojë masa që në pamje të parë duken neutrale, por që në realitet mund të kenë një ndikim negativ mbi pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Për shembull, ligjet standarde që nuk marrin parasysh nevojat specifike të komuniteteve pakicë mund t'i marginalizojnë ata në qasjen ndaj arsimit, punësimit ose kujdesit shëndetësor. Në praktikë, GJEDNJ aplikon testin e proporcionalitetit për të përcaktuar nëse ka ardhur deri tek diskriminimi. Kjo nënkupton që, edhe kur një shtet vendos kufizime të caktuara ose bën dallime në trajtim, duhet të dëshmojë se këto kufizime janë të domosdoshme dhe proporcionale me qëllimin legjitim që dëshiron të arrijë. Për shembull, në situata ku janë në pyetje siguria ose interesi publik, shtetet duhet të sigurojnë që masat që ndërmarrin të mos cenojnë të drejtat e komuniteteve pakicë më shumë sesa është e nevojshme.

Lidhja me të drejtat e tjera:

Neni 14 shpesh përdoret në kombinim me të drejta të tjera që mund të jenë të rrezikuara nga diskriminimi ndaj grupeve pakicë. Për shembull, **e drejta për arsim** (neni 2, Protokollin 1), **liria e shprehjes** (neni 10), **liria e tubimit dhe e organizimit** (neni 11) dhe **liria e fesë** (neni 9) mund të preken nga diskriminimi ndaj grupeve pakicë, dhe dhe neni 14 ofron një bazë për të sfiduar një trajtim të tillë të pabarabartë.

Neni 14 i Konventës luan rolin kyç në mbrojtjen e komuniteteve pakicë, duke garantuar që asnjë pjesëtar i pakicave të mos diskriminohet në realizimin e të drejtave, pavarësisht bazave të diskriminimit (përkatësia etnike, feja, gjuha, etj.). Përmes praktikës së GJEDNJ-së, shihet se ky nen shpesh vendos standarde të larta për shtetet, duke kërkuar që çdo masë ose ligj që mund të ketë pasoja negative për grupet pakicë të justifikohet dhe të jetë proporcional me një qëllim legjitim. Kjo është thelbësore për të siguruar barazinë dhe për të parandaluar marginalizimin ose përjashtimin e komuniteteve pakicë nga të gjitha aspektet e jetës shoqërore.

- **Neni 1, Protokollin 12 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit:**⁸ Ky është një kuadër më i gjërë që përdoret për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në kontekstin e ndalimit të diskriminimit në të gjitha fushat e jetës, nga fitimi i pronës deri te e drejta për lirinë e shprehjes. Protokollin zgjeron ndalimin e diskriminimit të garantuar nga neni 14 i Konventës në të gjitha të drejtat që mbrohen nga Konventa Evropiane. Mundëson zbatimin më të gjerë të mbrojtjes kundër diskriminimit, pasi zbatohet për çdo të drejtë që njihet në legjislacionin e shtetit nënshkruar, edhe nëse kjo e drejtë nuk është e përfshirë drejtpërdrejt në dispozitat e tjera të Konventës.

Për komunitetet pakicë, Protokollin 12 paraqet një mbrojtje kyçe, pasi mundëson luftën kundër diskriminimit në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë qasjen në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, kulturë dhe të drejta të tjera themelore. GJEDNJ në disa prej aktgjykimeve të saj ka theksuar se shteti duhet të sigurojë që të gjithë qytetarët e tij, duke përfshirë anëtarët e komuniteteve pakicë, të kenë mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat, pavarësisht prejardhjes etnike, gjuhës, fesë apo karakteristikave të tjera që përbëjnë një grup pakicë. Për shembull, siç u përmend më herët, në çështjen **Sejdiq dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës**, Gjykata konstatoi se kuadri ligjor ekzistues, i cili përjashton disa grupe pakicë (në këtë rast Romët dhe Hebrenjtë) nga jeta politike e vendit, përfaqësojnë shkeljen e ndalimit të diskriminimit sipas nenit 1 të Protokollit 12, sepse këto rregullore kanë lejuar që disa qytetarë të përjashtohen nga e drejta për zgjedhje dhe pjesëmarrje politike për shkak të përkatësisë etnike. Ndalimi i diskriminimit i parashikuar nga ky nen përfshin edhe mbrojtjen kundër diskriminimit ndaj kulturave, gjuhëve dhe identiteteve të pakicave, duke kontribuar në sigurimin e barazisë dhe mbrojtjen nga stereotipet negative dhe marginalizimi.

- **Neni 2, Protokollin 1 – E drejta për arsim:**⁹ Ky nen mundëson që të gjithë njerëzit, përfshirë anëtarët e grupeve pakicë dhe etnike,

⁸ https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_bos

⁹ https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_2_protocol_1_bos

kanë të drejtën për arsim pa diskriminim. Gjithashtu, në disa raste, anëtarëve të pakicave mund t'u lejohet përdorimi i gjuhës së tyre në institucionet arsimore. Shtetet nënshkruese janë të detyruara të respektojnë të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bidnjat e tyre fetare dhe filozofike. Për komunitetet pakicë, e drejta për arsim përfshin jo vetëm qasjen në institucionet arsimore, por edhe përshtatjen e sistemit arsimor për nevojat e tyre specifike, siç është përdorimi i gjuhës së pakicës, rëndësia kulturore dhe fetare e mësimdhënies, si dhe respektimin e kërkesave të veçanta identitare. Në praktikë, GJEDNJ ka konstatuar se shteti nuk mund të kufizojë të drejtën e grupeve pakicë për arsim që reflekton identitetin e tyre. Në çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Çekisë*¹⁰, Gjykata vendosi se një sistem arsimor që ndan padrejtësisht fëmijët e grupeve pakicë (sidomos fëmijët romë) në shkolla të veçanta, përfaqëson shkelje të të drejtës për arsim. Gjykata theksoi se, në kontekstin e të drejtave të pakicave, është e nevojshme të sigurohet qasja në një arsim që jo vetëm që garanton mundësi të barabarta për përvetësimin e njohurive, por edhe ruajtjen dhe zhvillimin e identiteteve kulturore të pakicave përmes programeve arsimore që respektojnë nevojat specifike kulturore, gjuhësore dhe fetare të grupeve pakicë. Gjithashtu, neni 2, Protokolli 1, parashikon që pakicat duhet të kenë qasje në institucione arsimore që respektojnë kulturën dhe gjuhën e tyre, dhe që arsimi duhet të jetë i orientuar në eliminimin e përjashtimit shoqëror dhe mundësimin e barazisë.

- **Neni 9 – E drejta për lirinë e fesë:** Neni 9 i Konventës garanton të drejtën për lirinë e besimit fetar, e cila përfshin të drejtën për të praktikuar, ndryshuar dhe shprehur besimet fetare. Në kontekstin e komuniteteve pakicë, ky nen ofron një mbrojtje të rëndësishme për anëtarët e grupeve fetare pakicë, duke u mundësuar atyre praktikimin e lirë të fesë së tyre, pa ndërhyrje nga autoritetet ose grupe të tjera.

10 [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-83256%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-83256%22]})

GJEDNJ në disa aktgjykime ka theksuar rëndësinë e lirisë së besimit fetar, veçanërisht në raste kur komunitetet fetare pakicë përballohen me diskriminim ose kufizime në lirinë e shprehjes së besimeve fetare. Për shembull, në çështjen *Manoussakis dhe të tjerët kundër Greqisë*¹¹, Gjykata theksoi se e drejta për lirinë e besimit fetar është një bazë për lirinë dhe dinjitetin personal dhe se shtetet duhet të mundësojnë për të gjitha grupet, përfshirë pakicat, të drejtën për të organizuar aktivitete fetare në përputhje me bindjet e tyre.

Gjithashtu, neni 9 mbron edhe të drejtat e pakicave që të mos detyrohen të shprehin publikisht besimet fetare ose praktikat që nuk janë në përputhje me bindjet e tyre, që është shumë e rëndësishme në shoqëritë multikulturore

- **Neni 10 – Liria e shprehjes**

Neni 10 garanton të drejtën për lirinë e shprehjes. Ky nen është veçanërisht i rëndësishëm për komunitetet pakicë, pasi u mundëson atyre të shprehin lirisht mendimet, veçoritë kulturore dhe identitetin, edhe kur këto mund të jenë në kundërshtim me normat kulturore dominante.

GJEDNJ në shumë raste ka interpretuar qartë këtë nen si një instrument kyç për mbrojtjen e të drejtave të grupeve pakicë për shprehje publike dhe ruajtjen e veçorive të tyre kulturore dhe identitare. Në çështjen *Sidiropoulos dhe të tjerët kundër Greqisë*¹², Gjykata theksoi se liria e shprehjes është thelbësore për zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe përfshin të drejtën e grupeve pakicë në organizimin e aktiviteteve politike dhe kulturore pa frikë nga represioni. Në këtë kontekst, e drejta për lirinë e shprehjes mund të përfshijnë të drejtën për përdorimin e gjuhës së pakicave, manifestimet kulturore, si dhe të drejtën e informimit dhe arsimit në përputhje me specifikat kulturore dhe gjuhësore të

11 <https://uredzastupnika.gov.hr/UserDocsImages//dokumenti/Edukacija//Vodi%C4%8D%20-%20%C4%8Dl.%209.%20Konvencije.pdf>

12 [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-58205%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-58205%22]})

komuniteteve pakicë. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të jetë subjekt i kufizimeve, me kusht që ato kufizime të jenë të justifikuara dhe proporcionale.

- **Neni 11 – Liria e tubimit edhe organizimit**

Neni 11 mbron të drejtën për lirinë e tubimit dhe organizimit, gjë që është me rëndësi të veçantë për komunitetet pakicë, të cilat mund të mblidhen me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre, si dhe ruajtjen e identitetit kulturor. Ky nen u mundëson grupeve pakicë të krijojnë organizata, parti politike, grupe kulturore dhe fetare, duke garantuar kështu mundësinë për veprim kolektiv dhe realizimin e të drejtave në shoqëri.

Në praktikë, GJEDNJ ka theksuar disa herë rëndësinë e këtij neni për komunitetet pakicë, ku Gjykata arriti në përfundim se e drejta për lirinë e tubimit nuk duhet të kufizohet vetëm sepse tubimi ka për qëllim promovimin e interesave të një komuniteti pakicë. Gjykata gjithashtu ka theksuar se kufizimet e vendosura nga shteti mund të jenë të justifikuara vetëm nëse janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, për shembull në rastet kur ekziston kërcënim për sigurinë publike.

Në kontekstin e të drejtave të pakicave, ky nen përfshin gjithashtu të drejtën e tubimit me qëllim ruajtjen e trashëgimisë etnike, kulturore dhe fetare, si dhe organizimin e protestave dhe aktiviteteve të tjera që mund të synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave, luftën kundër diskriminimit ose promovimin e pjesëmarrjes politike.

2. DALLIMI I TË DREJTAVE KOLEKTIVE DHE INDIVIDUALE TË KOMUNITETEVE PAKICË

Në kuadrin ligjor të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtat e pakicave përfshijnë si të drejtat individuale, ashtu edhe të drejtat kolektive, me theks të veçantë në ndalimin e diskriminimit dhe detyrimin e shteteve për të respektuar identitetin e komuniteteve pakicë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në praktikën e saj

shpesh interpreton këto të drejta në kontekstin e rasteve specifike të diskriminimit ose mohimit të të drejtave, që kontribuon mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të pakicave në nivel evropian. Këto dy lloje të drejtash kanë implikime të ndryshme ligjore dhe praktike.

- **Të drejtat individuale të komuniteteve pakicë** lidhen me të drejtat e çdo individi brenda komunitetit pakicë. Këto të drejta mund të realizohen në mënyrë individuale dhe bazohen në të drejtat universale të njeriut, siç janë e drejta për jetën, lirinë, sigurinë, e drejta për arsim, liria e shprehjes dhe e drejta për privatësi. Sipas Konventës Evropiane, anëtarët e pakicave gëzojnë të gjitha këto të drejta në mënyrë të barabartë me anëtarët e popullatës shumicë. Nëse një individ nga komuniteti pakicë diskriminohet në bazë të përkatësisë etnike ose fetare, mund të paraqesë një ankesë kundër shtetit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata do të shqyrtojë nëse është shkelur ndalimi i diskriminimit (neni 14 i ECHR) ose të drejta të tjera përkatëse.
- **Të drejtat kolektive të komuniteteve pakicë** lidhen me të drejtat e komuniteteve pakicë si një tërësi, në kuptimin e mbrojtjes së identitetit, gjuhës, kulturës dhe fesë së tyre. Këto të drejta u mundësojnë komuniteteve pakicë të kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre kulturor dhe gjuhësor, si dhe të marrin pjesë në jetën publike pa frikë nga asimilimi ose humbja e veçorive të tyre specifike. Të drejtat kolektive mund të përfshijnë të drejtën për përdorimin e gjuhës së pakicës në institucionet arsimore, kulturore dhe administrative, të drejtën për qasje në arsim ose mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konfirmuar se e drejta e komunitetit pakicë për përdorimin e gjuhës së tyre në institucionet arsimore është një e drejtë legjitime kolektive që shteti duhet ta respektojë.

Dallimi në qasje:

- **Të drejtat individuale** zakonisht zbatohen në situata konkrete dhe u mundësojnë individëve të kërkojnë drejtësi, ndërsa **të drejtat kolektive** përfshijnë një kornizë më të gjerë ku komunitetet pakicë si një tërësi kanë të drejtat që lidhen me mbijetesën dhe ruajtjen e

identiteteve dhe kulturave të tyre specifike.

- **Të drejtat individuale** mund të realizohen përmes padive në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, ndërsa **të drejtat kolektive** zakonisht realizohen përmes kornizave normative të miratuara nga shteti (ligjet për mbrojtjen e pakicave, ligjet gjuhësore, politikat kulturore).

III DISA NGA AKTGJYKIMET KRYESORE TË GJEDNJ PËR TË DREJTAT E PAKICAVE

GJEDNJ ka miratuar disa aktgjykime në mënyrë të përsëritur që kanë formësuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Në këtë seksion, do të analizojmë disa nga vendimet më të rëndësishme të GJEDNJ që lidhen me të drejtat e pakicave.

1. **Presuda Aktgjykimi në çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (2007)***¹³: Ky është një nga aktgjykimeve më të rëndësishme të GJEDNJ në lidhje me mbrojtjen e të drejtave arsimore të pakicave. Në këtë rast, Gjykata konstatoi diskriminimin e fëmijëve romë në sistemin arsimor, duke vendosur se është shkelur e drejta për arsim (neni 2 i Protokollit 1) në lidhje me të drejtën për barazi para ligjit (neni 14). Gjykata vlerësoi se fëmijët romë ishin diskriminuar pasi ishin transferuar në shkolla për fëmijë me nevoja të veçanta, pa një vlerësim të duhur.

Parimi: E drejta për arsim pa diskriminim, veçanërisht në lidhje me përkatësinë etnike. Gjykata konstatoi se shteti duhet të sigurojë qasje të barabartë në arsim për të gjithë nxënësit, përfshirë edhe grupet pakicë, dhe se nuk mund të ketë diskriminim sistematik në institucionet arsimore. Përmes këtij aktgjykimi, GJEDNJ theksoi qartë se grupet pakicë, duke përfshirë Romët, kanë të drejtë për trajtim të barabartë në institucionet arsimore dhe se segregimi mbi bazën e përkatësisë etnike përbën shkelje të të drejtave të njeriut.

2. **Aktgjykimi në çështjen *Sejdiq dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës (2009)***¹⁴: Ky aktgjykim është një nga rastet më të

¹³ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-83256%22%5D%7D>

¹⁴ <https://hudoc.echr.coe.int/#%7B%22fulltext%22:%5B%22Sejdic%20Finci%20v%20Bosnia%22%5D%22%22%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAM->

njohura që lidhet me të drejtat e pakicave në kontekstin e të drejtave politike dhe pjesëmarrjes në pushtet. Në këtë çështje, GJEDNJ shqyrtoi rregullimin kushtetues të Bosnjës dhe Hercegovinës, veçanërisht presidencën trepalëshe. Dy paditësit, pjesëtarë të komuniteteve pakicë (Romë dhe Hebrenj), pretenduan se u ishte mohuar e drejta për të kandiduar për Presidencën e Bosnjës dhe Hercegovinës, pasi rregullimi kushtetues i vendit e lejonte kandidimin vetëm për tre popuj konstitutivë (Bosnjakët, Kroatët dhe Serbët). Gjykata konkludoi se pjesëtarët e grupeve etnike pakicë ishin diskriminuar, pasi nuk kishin të drejtë të kandidohen për poste të larta politike. Gjykata vendosi që Kushtetuta e Bosnjës dhe Hercegovinës përbën diskriminim ndaj grupeve të tjera etnike dhe se përjashtimi i Romëve dhe Hebrenjve nga ky trup përfaqësues përbente diskriminim mbi baza etnike, duke shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Parimi: E drejta për pjesëmarrje politike pa diskriminim etnik. Gjykata vendosi që kufizimet kushtetuese që diskriminojnë pjesëtarët e komuniteteve pakicë përsa i përket pjesëmarrjes politike janë në kundërshtim me Konventën Evropiane. Ky aktgjykim është i rëndësishëm sepse i kujton shteteve se janë të detyruara të sigurojnë qasje të barabartë për komunitetet pakicë në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, përfshirë pjesëmarrjen politike.

- 3. Aktgjykim i në çështjen *Sampanis dhe të tjerë kundër Greqisë (2008)*¹⁵:** E drejta për qasje të barabartë në arsim dhe lufta kundër segregimit. Ky rast lidhet me diskriminimin e komunitetit rom, veçanërisht në fushën e arsimit. Në aktgjykim, GJEDNJ shqyrtoi çështjen e segregimit të nxënësve romë në Greqi, ku fëmijët romë ishin vendosur në shkolla të ndara, çka përbente shkelje të drejtës së tyre për arsim dhe të barazisë para ligjit. Gjykata vendosi që

[BER%22,%22CHAMBER%22\],%22itemid%22:\[%22001-96491%22\]}](#)

15 https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_2_protocol_1_bos

diskriminimi i nxënësve romë në sistemin arsimor grek përbënte shkelje të nenit 2 të Protokollit 1 (e drejta për arsim) dhe nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për barazi).

Parimi: E drejta për qasje të barabartë në arsim pa diskriminim, duke përfshirë ndalimin e segregimit në baza të përkatësisë etnike. Gjykata theksoi se sistemi arsimor duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë nxënësit, pavarësisht përkatësisë etnike, dhe se segregimi i nxënësve romë në shkolla është i papranueshëm. Ky aktgjykim konfirmon më tej obligimin e shteteve për të eliminuar diskriminimin në institucionet arsimore.

4. **Aktgjykimi në çështjen *Bayatyan kundër Armenisë (2011)*¹⁶:** E drejta për lirinë e fesë dhe ndërgjegjes për komunitetet fetare pakicë. Në këtë rast, GJEDNJ shqyrtoi të drejtën për lirinë e fesë dhe ndërgjegjes në kontekstin e shërbimit ushtarak. Bayatyan, që ishte anëtar i Kishës Armene, refuzoi të kryente shërbimin ushtarak për arsye fetare, duke u thirrur në të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes. Gjykata vendosi që Armenia kishte shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi nuk kishte siguruar të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për anëtarët e komuniteteve fetare pakicë. Këtu bëhet fjalë për të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes si pjesë e të drejtave fetare të komuniteteve fetare pakicë.

Parimi: E drejta për lirinë e fesë dhe ndërgjegjes, me fokus të veçantë në komunitetet fetare pakicë. Gjykata theksoi se shteti duhet të sigurojë shërbim alternativ për ata që për arsye fetare nuk mund të kryejnë shërbimin ushtarak. Ky aktgjykim forcon të drejtat e komuniteteve fetare pakicë për liri të ndërgjegjes dhe fesë, si dhe njohjen e nevojave të tyre specifike brenda sistemeve shtetërore.

¹⁶ https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/fs_conscientious_objection_hrv

5. Aktgjykimi në çështjen *Vučković dhe të tjerë kundër Serbisë (2012)*¹⁷: E drejta për barazi sociale pa diskriminim etnik. Kjo çështje ka të bëjë me diskriminimin ndaj anëtarëve të pakicës shqiptare në Serbi, të cilët pretendonin se u ishte mohuar e drejta për pension, edhe pse kishin shërbyer në ushtri. Gjykata vendosi që refuzimi për të paguar pensionet për ushtarët shqiptarë ishte diskriminues. Gjykata konstatoi se Serbia kishte shkelur të drejtën për barazi sociale dhe ndalimin e diskriminimit (neni 14, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 12) duke refuzuar pagesën e pensioneve për ish-ushtarët me kombësi shqiptare. Gjykata vlerësoi se diskriminimi ishte bazuar në përkatësinë etnike, gjë që përbën shkelje të Konventës Evropiane.

Parimi: E drejta për siguri sociale dhe ndalimi i diskriminimit etnik në qasjen e drejtave sociale. Gjykata theksoi qartë se shteti duhet të sigurojë të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët, përfshirë komunitetet pakicë, dhe se nuk mund të ketë diskriminim mbi bazën e përkatësisë etnike në lidhje me të drejtat sociale, siç janë pensionet.

6. Aktgjykimi në çështjen *Gjorgjević kundër Kroacisë (2012)*¹⁸: Në këtë rast, Gjykata shqyrtoi përgjegjësinë e Kroacisë për dhunën dhe ngacmimin ndaj një personi me aftësi të kufizuara me origjinë rome. Ankimi lidhej me faktin se Kroacia ishte përgjegjëse për mbrojtjen e pamjaftueshme të viktimës nga krimet e urrejtjes dhe dhunës. Gjykata vendosi që autoritetet kroate kishin shkelur të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi dhe krimet e urrejtjes, pasi nuk kishin reaguar siç duhet ndaj incidenteve që përfshinin dhunën ndaj personit rom me aftësi të kufizuara.

¹⁷[https://hudoc.echr.coe.int/#%7B%22fulltext%22:%5B%22Vu%C4%8Dkovi%C4%87%20and%20others%20v%20Srbije%20\(2012\)%22,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D%22%7D](https://hudoc.echr.coe.int/#%7B%22fulltext%22:%5B%22Vu%C4%8Dkovi%C4%87%20and%20others%20v%20Srbije%20(2012)%22,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22%5D%22%7D)

¹⁸ <https://uredzastupnika.gov.hr/UserDocsImages/dokumenti/Presude%20i%20odluke/%C4%90OR%C4%90EVI%C4%86%20protiv%20Hrvatske.pdf>

Parimi: E drejta për mbrojtje nga dhuna dhe krimet e urrejtjes, me theks të veçantë për grupet e cenushme, siç janë personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e komuniteteve pakicë. Gjykata theksoi përgjegjësinë e shtetit për të siguruar mbrojtje adekuate për të gjithë qytetarët, veçanërisht atyre që janë në një pozitë shumë të marginalizuar, si Romët me aftësi të kufizuara.

3.1. PARIMET KRYESORE NGA PRAKTIKA GJYQËSORE E GJEDNJ

Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut tregojnë se të drejtat e komuniteteve pakicë përfshijnë jo vetëm liritë dhe të drejtat individuale, por edhe interesat kolektive që lidhen me ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe fetar. Përmes një praktike të pasur, Gjykata ka dhënë udhëzime të qarta për mënyrën se si shtetet duhet të mbrojnë të drejtat e pakicave. Por, edhe kur këto mbrojtje janë të pamjaftueshme, GJEDNJ ofron një bazë të qartë për ndërhyrje dhe mbikëqyrje ligjore. Në bazë të analizave të këtyre aktgjykimeve, mund të identifikohen parimet kryesore që GJEDNJ ka vendosur dhe që lidhen me të drejtat e pakicave:

- **Ndalimi i diskriminimit (Neni 14 i ECHR/KEDNJ):** Pakicat nuk duhet të diskriminohen në bazë etnike, fetare, kulturore apo gjuhësore në fusha si arsimi, punësimi, pjesëmarrja politike dhe qasja në shërbime. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në pothuajse të gjitha aktgjykimet që lidhen me të drejtat e pakicave, zbaton nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili ndalon diskriminimin mbi çfarëdo baze, duke përfshirë përkatësinë etnike, gjuhën, fenë, orientimin seksual dhe të tjera.
- **E drejta për ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor:** GJEDNJ njeh të drejtën e komuniteteve pakicë për ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe fetar, dhe shtetet janë të detyruara të respektojnë dhe të promovojnë këto vlera. Një nga parimet kryesore të përcaktuara nga GJEDNJ është se shteti ka detyrimin jo vetëm të mbrojë të drejtat e njeriut, por edhe të mbrojë në

mënyrë aktive identitetin kulturor të komuniteteve pakicë. Kjo përfshin të drejtën për arsimim në gjuhën amtare, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe mundësinë për të shprehur identitetin në jetën publike. E drejta e komuniteteve pakicë për të përdorur gjuhën e vet në proceset arsimore, administrative dhe gjyqësore konsiderohet një element kyç në mbrojtjen e identitetit pakicë.

- **E drejta për pjesëmarrje politike:** Të gjithë qytetarët, përfshirë anëtarët e pakicave, duhet të kenë mundësi të barabarta në pjesëmarrjen politike, pa diskriminim bazuar në përkatësinë etnike ose fetare.
- **E drejta për qasje të barabartë në arsim:** Sistemi arsimor duhet të jetë inkluziv dhe i strukturuar në mënyrë që të mundësojë qasje të barabartë në arsim për të gjitha komunitetet, pa segregim dhe diskriminim, duke njohur nevojat e veçanta të komuniteteve pakicë. E drejta për arsim, si një nga të drejtat themelore të njeriut, shpesh përdoret në kontekstin e të drejtave pakicë, pasi mundëson ruajtjen e identitetit kulturor të anëtarëve të pakicave. Gjykata ka përcaktuar se trajtimi i pabarabartë në sistemin arsimor, si dhe segregimi i nxënësve të komuniteteve pakicë, përbëjnë shkeljen e drejtave të tyre të njeriut.
- **E drejta për lirinë e fesë:** Komunitetet e pakicave kanë të drejtën për lirinë e besimit, përfshirë të drejtën në kundërshtim të ndërgjegjes.

TRENDET NË PRAKTIKËN GJYQËSORE

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në dekadat e fundit tregon një evolucion të rëndësishëm në qasjen ndaj të drejtave të pakicave. Gjykata gradualisht zgjeroi interpretimin e këtyre drejtave, me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e interesave specifike të grupeve pakicë, por edhe integrimin e tyre në korniza më të gjera shoqërore. Aktgjykimet e GJEDNJ tregojnë fokus në rritje në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë, veçanërisht në fushën e arsimit, pjesëmarrjes politike dhe lirisë së shprehjes. Theksi u vu në të drejtat e pakicave në ruajtjen e identitetit të tyre, si dhe mbrojtjen nga diskriminimi sistematik, veçanërisht ndaj romëve dhe grupeve të tjera etnike, duke theksuar nevojën për masa aktive shtetërore në luftën kundër diskriminimit. Disa nga trendet kryesore në praktikën gjyqësore përfshijnë:

1. Njohja e të drejtave të pakicave në kuptim më të gjerë: Një nga trendet kryesore në praktikën e GJEDNJ-së është zgjerimi i interpretimit të të drejtave të pakicave, në mënyrë që të përfshijë aspekte të identitetit kulturor dhe autonomisë. Gjykata është gjithnjë e më e prirur të njohë domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave kulturore, gjuhësore dhe fetare të grupeve pakicë, në mënyrë që t'u mundësojë atyre të ruajnë trashëgiminë dhe traditat e tyre kulturore brenda komunitetit më të gjerë shoqëror. Kjo qasje nuk i referohet vetëm ruajtjes së të drejtave të pakicave në kuptimin më të ngushtë, por edhe kontributit të tyre aktiv në pluralizmin dhe diversitetin social.

2. Diskriminimi i grupeve pakicë në arsim dhe të drejtat politike

Diskriminimi i grupeve pakicë, veçanërisht në kontekstin e arsimit dhe të drejtave politike, mbetet një nga aspektet më të rëndësishme të proceseve gjyqësore para GJEDNJ-së. Gjykata ka theksuar vazhdimisht se shtetet kanë detyrimin të garantojnë barazi dhe mundësi të barabarta për grupet pakicë në qasjen ndaj arsimit, jetës politike dhe fushave të tjera kyçe të angazhimit shoqëror.

Arsimi: Gjykata ka krijuar një praktikë të qartë në lidhje me të drejtat arsimore të grupeve pakicë, duke vlerësuar se sistemet arsimore duhet të jenë të përshtatura për nevojat specifike të komuniteteve pakicë, përfshirë përdorimin e gjuhëve të pakicave dhe mësimin mbi veçantitë kulturore.

Të drejtat politike: Sa i përket të drejtave politike, GJEDNJ vazhdimisht ka treguar rëndësinë e garantimit të lirisë së grupeve pakicë për të marrë pjesë në jetën politike. Në rastet ku partitë politike ose sistemet zgjedhore nuk lejojnë qasje të barabartë për kandidatët nga grupet pakicë, Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës për të marrë pjesë lirshëm në procesin politik, gjë që është e rëndësishme për ruajtjen e autonomisë politike të pakicave.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për sa i përket të drejtave të pakicave tregon përparim të vazhdueshëm në njohjen dhe mbrojtjen të këtyre drejtave, përfshirë identitetin kulturor, autonominë dhe të drejtën për barazi. Gjykata ka vendosur qartë themelet për zhvillimin e mbrojtjes ligjore të grupeve pakicë, veçanërisht në kontekstin e arsimit, të drejtave politike dhe qasjes në shërbimet shtetërore. Trendet në praktikën gjyqësore tregojnë se shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa konkrete për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësisë etnike, kulturore apo fetare.

Mali i Zi është në rrugën e duhur për të harmonizuar legjislacionin e tij në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave me standardet evropiane, por nevojiten investime të mëtejshme për zbatimin e këtyre ligjeve në praktikë. Komunitetet pakicë kanë një rol kyç në shfrytëzimin e mekanizmave ekzistues të mbrojtjes dhe në përmirësimin e mëtejshëm të të drejtave të tyre përmes arsimit, angazhimit politik dhe përdorimit të instrumenteve ndërkombëtare gjyqësore dhe ligjore për mbrojtje. Praktika evropiane gjyqësore përbën një burim të rëndësishëm për forcimin e këtyre të drejtave për arritjen e barazisë. Megjithatë, ende ekzistojnë sfida në zbatimin e këtyre standardeve, veçanërisht në lidhje me zbatimin e ligjit në praktikë, duke përfshirë sigurimin e mbrojtjes adekuate nga diskriminimi, arsimin në gjuhën e pakicave dhe pjesëmarrjen e pakicave në jetën politike.

REKOMANDIME PËR KOMUNITETET PAKICË

Si të përdoret praktika evropiane për mbrojtjen e të drejtave të veta

Për komunitetet pakicë në Mal të Zi është e rëndësishme të përdorin mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe evropian. Në bazë të aktgjykimeve dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), komunitetet pakicë mund të ndërmarrin veprime konkrete për mbrojtjen e të drejtave të tyre:

- **Rëndësia e mbrojtjes së të drejtave të pakicave përmes mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe evropianë:** Përdorimi i mekanizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave. Komunitetet pakicë në Mal të Zi duhet të shfrytëzojnë mekanizmat kombëtarë të mbrojtjes të drejtave, nisur nga gjykatat vendore si hap i parë për mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe t'i drejtohen Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjykatat kombëtare në Mal të Zi janë të detyruara të zbatojnë standardet evropiane, prandaj është e rëndësishme të referohen aktgjykimeve përkatëse të GJEDNJ-së, të cilat mund të ndihmojnë në interpretimin e ligjeve. Në rast se gjykatat vendore nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme, qytetarët mund të paraqesin padi në GJEDNJ.
- **Arsimi dhe informimi i komuniteteve pakicë:** Të drejtat e pakicave në masë të madhe varen nga njohja dhe mbrojtja përmes proceseve ligjore. Anëtarët e komuniteteve pakicë duhet të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionit kombëtar. Rekomandohet organizimi i fushatave informuese që do të edukojnë anëtarët e komuniteteve pakicë mbi të drejtat e tyre sipas legjislacionit të Malit të Zi, por edhe sipas standardeve evropiane. Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë një rol kyç në ofrimin e mbështetjes për grupet pakicë përmes shërbimeve konsultore dhe ligjore.

- **Pjesëmarrja në jetën politike:** Pjesëmarrja aktive politike është thelbësore për sigurimin e të drejtave të pakicave për barazi dhe ndalimin e diskriminimit. Përmes partive politike dhe sektorit civil, komunitetet pakicë mund të punojnë për promovimin e interesave dhe nevojave të tyre në proceset legjislative dhe ekzekutive. Përfaqësuesit e pakicave mund të përdorin gjithashtu raportet dhe rekomandimet nga burime ndërkombëtare për të përmirësuar politikat kombëtare.
- **Thirrje për bashkëpunim më të mirë midis organeve shtetërore dhe komuniteteve pakicë** për të siguruar zbatimin e plotë të të drejtave. Komunitetet pakicë duhet të jenë aktive në monitorimin dhe inicimin e ndryshimeve në legjislacion ku do të përmirësohen të drejtat e tyre. Duke marrë parasysh aktgjykimet e GJEDNJ-së, organizatat që merren me të drejtat e pakicave mund të propozojnë ndryshime konkrete në ligje për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të tyre në përputhje me standardet evropiane.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Të drejtat e pakicave në Mal të Zi përfaqësojnë një segment kyç të të drejtave të njeriut, dhe mbrojtja dhe përmirësimi i tyre kërkojnë vëmendje të vazhdueshme në harmonizim me standardet ndërkombëtare. Krijimi i këtij manuali ka për qëllim njohjen më të mirë të rregulloreve në fushat që janë të rëndësishme për realizimin e të drejtave të pakicave. Manuali identifikon disa nga aktgjykimet kryesore të GJEDNJ-së që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Mal të Zi dhe ofron një pasqyrë të parimeve kyçe bazuar në praktikën e GJEDNJ-së. Aktgjykimet e GJEDNJ-së ofrojnë një kornizë të qartë standardesh që Mali i Zi duhet të respektojë për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave e pakicave. Mali i Zi, si anëtar i Këshillit të Evropës dhe kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, është në proces të harmonizimit të legjislacionit të tij me standardet evropiane, gjë që është një hap kyç drejt përmirësimit të të drejtave të pakicave. Në këtë kontekst, reformat legjislative dhe institucionale duhet të përqendrohen në zbatimin e mëtejshëm të këtyre standardeve, veçanërisht në fushat e arsimit, pjesëmarrjes politike dhe mbrojtjes së autonomisë kulturore të komuniteteve pakicë.

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së tregon një anagazhim të qartë për një interpretim më të gjerë të të drejtave të pakicave, jo vetëm në aspektin e mbrojtjes nga diskriminimi, por edhe në kontekstin e njohjes të drejtave kulturore, gjuhësore dhe politike. Gjykata ka vendosur standarde të larta për shtetet anëtare në lidhje me detyrimet që kanë për garantimin e të drejtave të barabarta për grupet pakicë, si në arsim, ashtu edhe në jetën politike dhe segmente të tjera kyçe shoqërore. Kjo praktikë tregon qartë se komunitetet pakicë nuk janë vetëm subjekte pasive të mbrojtjes, por aktorë aktivë që kanë të drejtën të formojnë statusin e tyre shoqëror, duke përdorur mekanizmat e mbrojtjes të disponueshme në nivel ndërkombëtar. Gjithashtu, angazhimi proaktiv i komuniteteve pakicë në procesin e krijimit të ligjeve dhe politikave, si dhe përdorimi i të gjitha mekanizmave ligjorë të disponueshëm, mund të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse, ku të

drejtat e pakicave do të respektohen plotësisht.

Edhe pse janë bërë hapa të rëndësishme në mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Mal të Zi, ende ekzistojnë shumë fusha ku nevojiten reforma të mëtejshme dhe masa konkrete për të mundësuar realizimin e plotë të këtyre të drejtave. Për të siguruar që të drejtat e komuniteteve pakicë të zbatohen në mënyrë efektive, është e domosdoshme jo vetëm harmonizimi i mëtejshëm i legjisllacionit, por edhe zbatimi konkret dhe i përditshëm i këtyre ligjeve në praktikë. Praktika evropiane gjyqësore, me mbrojtje të qartë dhe të qëndrueshme të të drejtave të pakicave, përfaqëson një instrument kyç që komunitetet pakicë në Mal të Zi duhet ta përdorin aktivisht. Çdo aktgjykim i GJEDNJ-së që lidhet me pakicat vendos standarde që duhet të kthehen në masa konkrete në jetën e përditshme. Njohja dhe përdorimi i këtyre aktgjykimeve përfaqëson një hap strategjik në ndërtimin e një shoqërie me mundësi të barabarta, ku të drejtat e pakicave nuk do të jenë vetëm të njohura në letër, por edhe të mbrojtura në praktikë. Vetëm përmes përdorimit aktiv të këtyre mekanizmave ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave, së bashku me angazhimin politik dhe reformat në arsim, kulturë dhe legjisllacion, mund të kemi një shoqëri ku të gjithë qytetarët – pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, fetare apo kulturore – të gëzojnë liri dhe barazi të plotë.

BURIMET

- https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Questions_Answers_MNE
- https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Convention_MNE
- <https://rm.coe.int/okvirna-konvencija-za-zastitu-nacionalnih-manjina/168094dfe6>
- https://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Source/Charter-Text/ExplRpt_ba.pdf
- <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-71627%22%5D%7D>
- https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_6_criminal_srp
- <https://hudoc.echr.coe.int/#%7B%22fulltext%22:%5B%22Sejdic%20Finci%20v%20Bosnia%22%5D%2C%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%2C%22CHAMBER%22%5D%2C%22itemid%22:%5B%22001-96491%22%5D%7D>
- https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_bos
- https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_2_protocol_1_bos
- <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-83256%22%5D%7D>
- <https://uredzastupnika.gov.hr/UserDocsImages//dokumenti/Edukacija//Vodi%C4%8D%20-%20%C4%8DI.%209.%20Konvencije.pdf>
- <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-58205%22%5D%7D>
- <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-83256%22%5D%7D>
- <https://hudoc.echr.coe.int/#%7B%22fulltext%22:%5B%22Sejdic%20Finci%20v%20Bosnia%22%5D%2C%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%2C%22CHAMBER%22%5D%2C%22itemid%22:%5B%22001-96491%22%5D%7D>

- https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_2_protocol_1_bos
- https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/fs_conscientious_objection_hrv
- [https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:\[%22Vu%C4%8D-kovi%C4%87%20and%20others%20v%20Srbije%20\(2012\)%22\],%22documentcollectionid%22:\[%22GRAND-CHAMBER%22,%22CHAMBER%22\],%22itemid%22:\[%22001-165746%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/#{%22fulltext%22:[%22Vu%C4%8D-kovi%C4%87%20and%20others%20v%20Srbije%20(2012)%22],%22documentcollectionid%22:[%22GRAND-CHAMBER%22,%22CHAMBER%22],%22itemid%22:[%22001-165746%22]})
- <https://uredzastupnika.gov.hr/UserDocsImages/dokumenti/Pre-sude%20i%20odluke/%C4%90OR%C4%90EVI%C4%86%20protiv%20Hrvatske.pdf>

